



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN
Komiteti për Politikë dhe Financa
- KRYESUESI-
15 Nr.06-2
Lipjan, më 30.01.2026



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Z. _____

Në bazë të nenit 7 të Rregullorës së Punës të Kuvendit të Komunës së Lipjanit.

THËRRAS

Mbledhjen e 2-të të Komitetit për Politikë dhe Financa të KK-së së Lipjanit për të Mërkurën më 11.02.2026, në sallën II, kati i tretë, me fillim në ora 10,⁰⁰

Për këtë mbledhje propozoj këtë:

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 1-rë e KPF-së.
2. Raporti i shpenzimeve dhe të hyrave Janar-Dhjetor 2025.
3. Propozim Vendim për fillimin e procedurës për ndryshim plotësimin e Hartës Zonale të Komunës.
4. Propozim Vendim për lirim nga pagesa e borxheve të qirasë joprofitabile të përfituesve të banimit social.
5. Propozim Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për Qendrën për mbrojtjen e grave dhe fëmijëve – strehimoren në mbrojtje të viktimave të dhunës familjare dhe atyre të dhunës gjinore.
6. Propozim Vendim për shfuqizimin e Vendimit 15Nr.020/04-59398 datë 29.11.2024 për miratimin e ofertës së përzgjedhur nga Komisioni Vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të Komunës në Zonën Kadastrale në Lipjan.
7. Propozim Vendim për shfuqizimin e Vendimit 15Nr.462/01-4918 datë 28.01.2025 për miratimin e ofertës së përzgjedhur nga Komisioni Vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës në Zonën Kadastrale Babush i Muhaxherëve.
8. Propozim Vendim për formimin e Komisionit komunal për emërtimin e rrugëve të reja, shesheve dhe hapësirave publike në territorin e Komunës së Lipjanit.
9. Propozim Vendim për formimin e Komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës të paluajtshme të Komunës në ZK Konjuh.
10. Propozim Vendim për formimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave të palëve në procedurën e dhënies në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme.
11. Propozim Vendim për formimin e Komisionit përzgjedhës Ad.hoc për përzgjedhjen e drejtorëve në institucionet publike edukativo arsimore të Komunës së Lipjanit.
12. Propozim Vendim për themelimin e Këshillit Komunal për siguri në Bashkësi- KKSB.
13. Propozim Vendim për formimin e grupit punues për hartimin e Projekt-Rregullores së re të Punës së Kuvendit të Komunës së Lipjanit.

Së bashku me ftesë ju dërgojmë materialin për pikat e propozuar të rendit të ditës.



Kryesuesi
Daut Azemi